



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4038 Prot.

Tiranë, më 19.7 . 2021

URDHËR

Nr. 249 , Datë 19.7.2021

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“MEDIA, KOMUNIKIM DHE TRASHËGIMI KULTURORE” ME PROFILET
“GAZETARI DHE MULTIMEDIA” DHE “TRASHËGIMI KULTURORE”, NË
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI” VLORË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Media, komunikim dhe trashëgimi kulturore” me dy profile “Gazetari dhe Multimedia” dhe “Trashëgimi kulturore” me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Media, komunikim dhe trashëgimi kulturore” me dy profile “Gazetari dhe Multimedia” dhe “Trashëgimi kulturore”, në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Media, komunikim dhe trashëgimi kulturore” me dy profile “Gazetari dhe Multimedia” dhe “Trashëgimi kulturore”, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

